



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

Tiranë, me 26.01.2021

Dokument parlamentar

V E N D I M

Nr. 1/2021

**PËR RISHPALLJEN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES SË KRYETARIT TË  
KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 93, pika 2, nenit 94, pika 2, të ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe bazuar në nenin 34, të Rregullores së Kuvendit,

KOMISIONI PËR EDUKIMIN DHE MJETET E INFORMIMIT PUBLIK

V E N D O S I:

- I.** Rishpalljen e një vendi vakant për kryetar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.
- II.** Të ftohen për paraqitjen e kandidaturave për anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së, subjektet e mëposhtme:
  - a) shoqatat dhe grupimet e mediave elektronike;
  - b) shoqatat e medias së shkruar;
  - c) profesoratin dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike;
  - ç) profesoratin e së drejtës, gazetari-komunikimit dhe ekonomisë, shoqatat e juristëve dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë;
  - d) organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve ose kërkimeve në politikat publike, ose përfaqësues të shoqatave që veprojnë në fushën e mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuar.
- III.** Shërbimet e Kuvendit të shpallin dhe të bëjnë publike vakancën në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e informimit publik. Në shpallje të përcaktohet edhe dokumentacioni që duhet

të shoqërojë propozimin e kandidaturës nga subjektet e sipërpërmendura, për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve ligjore.

**IV.** Afati i paraqitjes së kandidaturave të propozuara, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, përfundon 20 ditë nga data e publikimit të këtij vendimi.

**V.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit.

**KRYETAR**

**Ramazan GJUZI**